



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit
Tirane

Detaje te ceshtjes civile me numer: 31025-03640-86-2016

Nr. i Ceshtjes	31025-03640-86-2016
Titulli i ceshtjes	Bledar Valikaj [Padiës] Kundër: Presidenti i Republikës [I Paditur]
Dt. e Regjistrimit	7/8/2016 12:00:00 AM
Lloji i ceshtjes	Te tjera
Baza ligjore	Neni 31, 32/a, 41 te K.Pr.Civile; Ligji nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin mosmarreshjeve administrative"; Neni 20 dhe 21 i Ligjit nr. 873 date 12.02.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e *****se Republikën e *****" i ndryshuar; Neni 149, pika 3 e Kushtetutes se ***** se ***** , Udhezimi nr.3 date 11.02.2015 *****t te ***** "Per proceduren e konkurimit te kandidatures per prokuror qe kane punuar gjyqtare, prokurore ose officer te policise gjyqesore" i ndryshuar; Vendimi nr. 25 date 13.02.2002 i Gjykes Kushtetuese.
Statusi i ceshtjes	Mbyllur
Gjyqtari	Altina Nasufi
Nr. i vendimit	86-2019-332
Dt. e vendimit	01-03-2019

Informacion per palet e ceshtjes

Emri	Tipi
	I Paditur
	Palë e Interesuar
***** X	Padiës
	Person i Tretë



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit
Tirane

Nr. Vendimit	86-2019-332
Dt. e vendimit	01-03-2019

Permbledhja e vendimit

Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë me vendimin nr. 2547, datë 23.05.2016 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Bledar Valikaj.
- Konstatimin e paligjshëm të veprimit administrativ të Presidentit të Republikës, për rrëzimin në heshtje të kandidaturës së paditësit Bledar Valikaj, i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm për t'u emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
- Detyrimin e palës së paditur, institucioni i Presidentit të Republikës që të bëjë emërimin e paditësit Bledar Valikaj si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, sipas propozimit të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 2971/57 prot., datë 30.10.2015.
- Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi në shumën 43.000 (dyzet e tre mijë) lekë, lihen në ngarkim të palës së paditur.
- Ky vendim është titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510/a të K.Pr.Civile dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarrimit, nga data që ky vendim merr formë të prerë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, duke filluar nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit dhe për palët në mungesë, nga e nesërmeja e marrjes dijeni për vendimin.

Kundër këtij vendimi në datë 07.06.2016 ka paraqitur ankim pala e paditur Institucioni i Presidentit të Republikës duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Bledar Valikaj:

- Paditësi Bledar Valikaj, ka përfunduar arsimin e lartë juridik dhe në vitin 2002 është emëruar oficer i policisë gjyqësore, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, po në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore. Në bazë të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 3, datë 11.02.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm "Për procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore", i ndryshuar, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është bërë shpallja e vendeve vakante për prokuror, në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, Sarandë, Mat, Pukë, Tropojë, Kurbin, Gjirokastër, Kukës dhe Krujë. Paditësi ka paraqitur kërkesë për të konkurruar në njërin prej vendeve vakante të shpallura për prokuror, të sipërpërmendura. Më pas, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është bërë njoftimi i kandidatëve që përmbushnin kriteret ligjore për datën e zhvillimit të testimit, ku ndërmyjet kandidatëve që përmbushnin kriteret ligjore ishte dhe paditësi Bledar Valikaj. Nga 49 kandidatë që kanë konkurruar për 9 (nëntë) vendet vakante të shpallura, paditësi ka rezultuar fitues, ku ka arritur që të grumbullojë 84.3 pikë, nga të cilat 65 pikë në testimin me shkrim dhe 19.3 pikë në testimin me gojë. Në vijim, pas dhënies së mendimit nga ana e Këshillit të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 2971/57 prot., datë 30.10.2015, me lëndë: "Propozime për emërim



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

prokurorësh", i ka propozuar Presidentit të Republikës, që z. Bledar Valikaj, oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, të emërohet prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Në ushtrim të kompetencave të tij ligjore e kushtetuese, Presidenti i Republikës, nuk është shprehur me dekret në lidhje me propozimin e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për emërimin e paditësit Bledar Valikaj, në detyrën e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

- Gjykata ka arsyetuar dhe vendosur në kundërshtim flagrant me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr. 8738, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Neni 149 pika 3 e Kushtetutës i jep Presidentit të Republikës kompetencën e emërimit dhe të shkarkimit të gjithë prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat e Kreut të Shtetit parashikohen në ligjin e posaçëm nr. 8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këtë ligj përcaktohet saktë gjithë procedura e emërimit të prokurorëve. Neni 21 i këtij ligji sqaron kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për prokurorë për emërimin e tyre, procedurën që ndiqet dhe mënyrën e emërimit. Pra, kandidatët që përmbushin kriteret përzgjidhen nga Prokurori i Përgjithshëm i cili ja propozon Presidentit të Republikës për dekretim. Është i shumë i rëndësishëm për t'u kuptuar nga gjykata, se Presidenti i Republikës gjykon dhe vendos mbi propozimin e prokurorit duke dekretuar emërimin, shkarkimin ose të heshtë mbi kandidaturën e propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Më qartë sqarohet në pikën 4 të po këtij neni ku qartësisht parashikohet një afat prekluziv brenda të cilit Presidenti duhet të vendosë në lidhje me propozimet e ardhura: *Presidenti, brenda 30 ditëve, dekretin emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.* Kjo dispozitë, i nje Presidentit të drejtën që të dekretojë ose jo kandidaturën e dërguar. Nëse vendos dekretimin, duhet të bëhet brenda 30 ditëve, por në të njëjtën kohë ligji i nje Presidentit edhe të drejtën të mos shprehet. Legjislatori në këtë rast ka qenë tejte i qartë në parashikimin e kompetencave të Presidentit të Republikës. Gjykata duke anashkaluar çdo prapësim të Institucionit të Presidentit të Republikës, ka arsyetuar duke bërë fillimisht një sqarim të institutit të heshtjes dhe të pushtetit diskrecionar administratës publike. E më pas, arsyeton se: *Dhënia e pushtetit diskrecionar autoritetit administrativ, nuk mund të kuptohet se është i pakufizuar nga kërkesat e ligjit.* Pra gjykata mendon se ***** i ka tejkaluar kompetencat e tij ligjore dhe kushtetuese. Gjykata gjithashtu shprehet se "Rrëzimi i kandidaturës së paditësit Bledar Valikaj, për prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm, duhej të ishte bërë vetëm në rastet e mosplotësimit të kriterëve ligjore, të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të ligjit nr. 8783/2001, nga ana e këtij të fundit.
- Së pari: gjykata gabon kur shprehet se: "Presidenti i Republikës ka rrëzuar propozimin", pasi Presidenti ka vlerësuar të heshtë në lidhje me këtë propozim si e drejtë ligjore që ja nje ligji, që është heshtja.

Së dyti: sipas gjykatës, çdo kandidat që konkurren për një vend vakant për prokuror, nëse plotëson kriteret duhet emëruar. Sipas gjykatës, roli i Presidentit të Republikës në emërimin e prokurorëve është thjesht një akt formal, sipas saj Presidenti i Republikës nuk ka nevojë të bëjë asnjë verifikim dhe nuk mund të ketë asnjë kundërshti objektive të bazuar në ligj, në lidhje me kandidaturat e propozuara nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi nëse kandidati i plotëson kriteret atëherë ai automatikisht duhet të emërohet. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, i pabazuar në ligj, pasi keqinterpreton dispozitat e ligjit dhe Kushtetutës.

- Gjykata ka shkelur rëndë një nga parimet kryesore të së drejtës që është parimi për një gjykatë të paanshme, të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Neni 6 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet". Në çështjen objekt gjykimi, paditësi ka kërkuar "Detyrimin e Presidentit të Republikës për të marrë në shqyrtim propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm" dhe "Detyrimin për t'u shprehur në lidhje me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin prokuror të kandidaturës se Bledar Valikaj". Çuditërisht gjykata me iniciativën e saj, pa qenë e



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

kërkuar nga paditësi ose nga palët, vendos "Detyrimin e palës së paditur, institucioni i Presidentit të Republikës që të bëjë emërimin e paditësit Bledar Valikaj". Ky veprim i gjykatës, lë vend për dyshime të forta për paanësinë e gjykatës dhe për objektivitetin në gjykimin e çështjes. Në këto kushte bazuar në arsyetimin e sipërcituar, kërkohet ndryshimi i vendimit nr. 2547, datë 23.05.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimi i padisë së paditësit Bledar Valikaj.

Me marrjen dijani mbi ankimin e palës së paditur, në datë 08.07.2016 (ka marrë dijani në datë 04.07.2015) paditësi Bledar Valikaj ka ushtruar të drejtën e apelit kundërshtues duke parashtruar këto shkaqe për mospranimin e ankimit të palës së paditur dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2547, datë 23.05.2016 të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë:

- Pretendimi i parë i palës së paditur (konstatimin e paligjshmërisë së veprimit juridik), në ankimin e bërë prej saj, është tërësisht i pabazuar në faktet dhe provat e administruara në gjykim, si dhe argumente ligjore. Pala e paditur në këtë gjykim, Presidenti i Republikës, ka pretenduar se Gjykata ka vendosur në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe ligjin organik për Prokurorinë, por për të kuptuar pathemelësinë e këtij pretendimi analizohen tagrat e Presidentit të Republikës sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, parë këto dhe në këndvështrimin e doktrinës sonë juridike. Presidenti i Republikës së Shqipërisë gëzon disa tagra, që lidhen me rolin e tij të quajtur ndryshe si "noter i *****", pra, me nënshkrimin e akteve të ndryshme. Ky term nënkupton që Presidenti ka një sërë detyrash ose të drejtash përkundrejt organeve të tjera, të cilat ai i kryen nëpërmjet akteve që u drejton atyre si: shpalljen e ligjeve (neni 84/1 i Kushtetutës së RSh); emërimin e anëtarëve të qeverisë (neni 96, 98 të Kushtetutës së RSh); emërimin e ambasadorëve (neni 92/dh i Kushtetutës së RSh); emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese (136/1, 125/1); emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm (neni 149/1).. etj, përfshirë këtu dhe dekretimin e prokurorëve të thjeshtë duke i emëruar ata sipas propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Lidhur me këto kompetenca, parimisht konsiderohet se kemi të bëjmë me praktika juridike, që si rregull, vihen në jetë ose inicoohen nga organe të tjera shtetërore, por që për hyrjen në fuqi dhe zbatimin përfundimtar të tyre nevojitet vënia në lëvizje e Presidentit të Republikës, i cili, duke u bazuar te parimi i sigurisë juridike dhe ai i kushtetutshmërisë, duhet t'i shpallë ato me anë të dekreteve të veshura me formën e një akti presidencial. I parë në këtë këndvështrim, krahasimi i Presidentit me një noter nuk është i tejkualuar, pasi edhe detyra e këtij të fundit konsiston pikërisht në drejtim të vërtetimit të origjinalitetit dhe saktësisë juridike të një dokumenti. Noteri nuk e realizon këtë detyrë në mënyrë mekanike, duke hedhur vetëm nënshkrimin e tij, por ai kontrollon, këshillohet dhe vërteton përmbajtjen e dokumentit. Kështu vepron edhe kryetari i shtetit. Pra, nëse do të përkufizohej roli i Presidentit në një republikë parlamentare, atëherë mund të thuhet se ai kufizohet kryesisht në aspektin formal ose protokollar, si dhe në përfaqësimin politik të shtetit. Lidhur me rolin e Presidentit në respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve mund të thuhet se ai e ushtron këtë kontroll, duke nxjerrë dekrete, të cilat kanë natyrën e akteve që sigurojnë dhe garantojnë zbatimin e së drejtës. (...kjo pjesë është marrë nga "Dr. Arta Vorpsi, botuar në "E drejta parlamentare dhe politikat ligjore," nr.XXIX, viti 2006")

Në rastin konkret, referuar dhe ligjit të posaçëm për prokurorinë, nëse kriteret janë plotësuar ose jo nga kandidati, si dhe rregullshmëria e procedurës së zgjedhjes së tij, mund të verifikohen nga Presidenti. Në këtë aspekt ai ushtron kompetencën e tij lidhur me sigurinë juridike dhe respektimin e së drejtës. Prokurori i Përgjithshëm zgjedh, midis disa kandidaturave të paraqitura, ata që renditen më lart në konkurrim (*ata që përmbushin kriteret e vendosura*) dhe Presidenti verifikon procesin e zgjedhjes së kandidaturave (*nga ana formale*), nëse është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin pra, nëse procesi ka qenë i rregullt. Përsa i përket kriterëve të tjera joformale, si aftësitë profesionale, bindjet politike, qëndrime të tjera subjektive të personave të zgjedhur, nuk është kompetencë e Presidentit të kontrollojë këto aspekte. Pra, nisur nga analiza e mësipërme mund të thuhet se Presidenti i RSH-së ka rolin e një kryetari shteti sipas atij që njihet nga regjimet e republikave parlamentare, pra, të një presidenti joqeverisës. Për këtë arsye funksionet e tij



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

duhen parë në drejtim të ruajtjes së sigurisë juridike dhe zbatimit të së drejtës, të kontrollit të rregullshmërisë së akteve të organeve më të larta shtetërore kushtetuese (krahasimin e tij si noter shtetëror) të përfaqësimit të shtetit dhe popullit si i tërë dhe të mishërimit tek ai të unitetit të popullit dhe të garantit të Kushtetutës.

- Në ankimin e saj, pala e paditur është konfuze edhe në mënyrën si e trajton çështjen duke demonstruar një mosnjohje totale të ligjit mbi Prokurorinë. Referuar ankimit, del që Presidenti nuk e ka rrëzuar propozimin, por ka heshtur. Kjo tregon një njohje aspak serioze të nenit 21, pika 4 të ligjit nr. 8737 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij neni është e shprehur qartë që nëse nuk e dekreton kandidaturën brenda 30 ditëve duke heshtur, kjo kandidaturë konsiderohet e rrëzuar. Pra në këtë rast nuk është Gjykata ajo që ka gabuar, por vetë ankuesi, duke treguar edhe një herë mënyrën empirike dhe subjektive si e ka trajtuar rastin në fjalë që nga shqyrtimi i propozimit deri tek ankimimi, duke mos iu referuar në asnjë rast ligjit por preferencave personale. Edhe në vazhdimin e arsytimit të bërë në ankim nga ankuesi, në paragrafin e mëposhtëm të ankimit, po në faqen nr. 5, ankuesi ngre pretendimet ndaj gjykatës duke u shprehur: "...Sipas gjykatës, roli i Presidentit të Republikës në emërimin e prokurorëve është thjesht një akt formal, sipas saj Presidenti i Republikës nuk ka nevojë të bëjë asnjë verifikim dhe nuk mund të ketë asnjë kundërshti objektive të bazuar në ligj, në lidhje me kandidaturat e propozuara nga Prokurori i Përgjithshëm...". Në fakt thelbi i padisë dhe përse paditësi i është drejtuar Gjykatës është pikërisht ky, pra që Presidenti pa bërë asnjë verifikim, pa pasur dhe pa ngritur asnjë kundërshti objektive, ndonëse i plotësonte gjithë kriteret ligjore, ka rrëzuar kandidaturën e propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Edhe gjatë gjykimit, pala e paditur, Presidenti nuk solli asnjë argument dhe nuk solli asnjë provë që të tregojë që të paktën ka tentuar të bëjë qoftë dhe një verifikim dhe ketë e justifikoi me argumentimin se është e drejtë e tij të refuzojë pa bërë asnjë verifikim. Edhe në këtë fakt shihen dy standartet e veprimit të tij ku nga njëra anë "ankohet" ndaj gjykatës se përse ajo shprehet që Presidenti nuk duhet të ketë rol aktiv dhe të bëjë verifikime apo kundërshti objektive, dhe nga ana tjetër në rastin e kandidaturës së paditësit Bledar Valikaj për prokuror, proklamoi të drejtën që ta refuzojë në heshtje pa bërë asnjë verifikim apo kundërshti objektive siç e kërkon vetë në ankim. Në këtë kontekst mund të thuhet se pretendimet e palës së paditur lidhur me pikën e parë të dispozitivit të vendimit të gjykatës (konstatimin e paligjshmërisë së veprimit juridik) nuk qëndrojnë dhe janë bërë në arsyetim të gabuar të ligjit. Ndërsa arsyetimi ligjor i gjykatës për pikën e parë të objektit të padisë është korrekt dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën e RSH si dhe me ligjin organik për prokurorinë.
- Pretendimi i dytë i palës së paditur, se është cënuar parimi i një gjykate të paanshme, është po ashtu, një pretendim i pabazuar në prova dhe në ligj. Pala e paditur në ankimin e ushtruar prej saj ka pretenduar se është shkelur parimi i një gjykate të paanshme, pasi gjykata referuar pikës së dytë të dispozitivit të vendimit të saj ka vendosur jo sipas kërkesës së palëve (shtesa e objektit të padisë). Edhe ky pretendim i palës së paditur nuk qëndron pasi, referuar parashikimit të nenit 3, 17 e 37 të ligjit nr. 49/2012, qëllimi i ligjvënësit gjatë hartimit dhe miratimit të këtij ligji, ka qenë jo vetëm për t'i siguruar gjykatës administrative kompetencën për të anuluar aktet administrative të paligjshme apo të konstatojë paligjshmërinë e veprimeve administrative, por edhe t'i lejojë gjykatat për të vendosur detyrime ligjore mbi institucionet e administratës. Kështu, lidhur me vendimin përfundimtar, gjykata ka të drejtë të anulojë aktin administrativ, ta konstatojë atë të pavlefshëm apo paligjshmërinë e veprimit administrativ dhe/ose t'i imponojë gjykimin e vet autoritetit administrativ (organit publik).
- Gjykata në këto raste, bazuar në doktrinën juridike tashmë të konsoliduar dhe në kuptim të ligjit nr. 49/2012 për gjykatat dhe gjykimin administrativ, me qëllim rivendosjen e të drejtave lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të subjekteve që mund të cënohen si pasojë e paligjshmërisë së veprimeve administrative, zgjidh pasojat e kësaj pavlefshmërie. Në këtë këndvështrim, pretendimi i dytë i ngritur në ankim nga pala e paditur është i pabazuar në ligj dhe nuk provon se në rastin konkret është shkelur parimi i një gjykate të paanshme. Gjykata Kushtetuese, në mënyrë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Kështu, ajo ka theksuar se *në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari, konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në fjalë, në një0 çështje të dhënë; dhe i dyti, në vlerësimin nëse gjyqtari*



REPUBLIKA E *****

Gjykata Administrative e Apelit Tirane

ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (Shih vendimin nr.18/2007 të Gjykatës Kushtetuese). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe super partes. (Shih vendimin nr.23/2008 të Gjykatës Kushtetuese). Janë këto arsye, të cilat kanë çuar në ngritjen në nivel kushtetues të parimit të paanshmërisë së gjyqtarit, i cili rrjedh nga parimi i lashte latin "nemo iudex in causa sua". Ky parim është mbështetur pikërisht në ekzistencën e premisë që gjyqtari të mos vendoset në pozitë të tillë, ku vendimmarrja e tij të jetë e dyshimte për shkak të pamundësisë për të reflektuar paanësinë dhe që çon në krijimin e dyshimit ose bindjes te palët se këto nuk po dëgjohen siç duhet nga gjykata.

- Por nisur nga analiza e mësipërme, referuar pretendimit të dytë në ankim të palës së paditur, si edhe fakteve dhe provave të kësaj çështjeje, konstatohet lehtë se në asnjë rast nuk mund të provohet dyshimi i palës së paditur se është shkelur parimi i paanshmërisë, në këndvështrim kjo dhe të nenit 6/1 të KEDNJ. Vendimtar mbetet përcaktimi nëse dyshimi mbi paanësinë është objektivisht i përcaktueshëm. (shih Delage & Magistrello V France (dec.) no.40028/98, ECHR 2002-11)
- Lidhur me pikën e fundit të objektit të padisë që ishte "...Detyrimi për t'u shprehur në lidhje me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin si Prokuror të kandidaturës së Bledar Valikaj...". Në ligjin nr. 8737 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", referuar përcaktimit të nenit 21 pika 4 e tij, rezultojnë se në zbatim të tij, Presidenti ka dy alternativa:

1. Të dekretojë brenda 30 ditëve emërimin në detyrë të kandidatit për prokuror..

2. Të rrëzojë duke lënë të kalojë afati 30 ditor i dekretimit, pra duke mos u shprehur, kandidaturën e propozuar për prokuror.

Siç shihet pala e paditur, Presidenti ose shprehet duke dekretuar kandidaturën ose e rrëzon me heshtje. Pra edhe në objektin e padisë, kërkimi i "...Detyrimin për t'u shprehur në lidhje me propozimin për emërimin prokuror të kandidaturës së Bledar Valikaj.." i parë në optikën e ligjit, nuk është asgjë më tepër dhe asgjë më pak se: *Detyrimi i palës së paditur institucioni i Presidentit të Republikës që të bëjë emërimin e paditësit Bledar Valikaj si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës sipas propozimit të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 2917/57, datë 30.10.2015..* i vendosur nga gjykata.

Pra edhe në këtë rast Gjykata ka vendosur drejt, ka zgjidhur çështjen në themel dhe mbi bazën e çfarë është kërkuar, duke interpretuar drejt dhe qartë ligjin.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, me vendimin datës 07.06.2016 ka vendosur pranimin e ankimit.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi dëgjoi pretendimet e paditësit që kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 2547, datë 23.05.2016 të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë duke marrë në konsideratë situatën ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ si dhe situatën aktuale ligjore, pra detyrimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të emëruar paditësin prokuror.



REPUBLIKA E *****

**Gjykata Administrative e Apelit
Tirane**

Përfaqësuesen e palës së paditur Këshillit të Lartë të Prokurorisë që e la në kompetencë të gjykatës të vendosë në lidhje me ligjshmërinë dhe të drejtën e paditësit dhe se Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të zbatojë çdo vendim të formës së prerë të gjykatës në përputhje me shpërndarjen dhe nevojat e prokurorive të shkallës së parë.

Si shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen,

Dispozitivi

VENDOSI

Lënien në fuqi të vendimit nr. 2547, datë 23.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me saktësimin e pikës 3 të pjesës urdhëruese të vendimit, në këtë mënyrë:

- Detyrimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të bëje emërimin si prokuror të paditësit Bledar Valikaj.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

U shpall ne Tirane sot, me date 06.02.2019

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.